

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË  
DEPARTAMENTI: AGROEKONOMI



**PUNIM DIPLOME - MASTER**

Ndikimi i investimeve të huaja direkte në rritjen ekonomike në Kosovë

Kandidate:

BSc.Njomza Ahmeti

Mentore:

Prof. Asoc. Dr. Jehona Shkodra

Prishtinë, 2021

## **Deklaratë**

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim me titull “Ndikimi i investimeve të huaja direkte në rritjen ekonomike në Kosovë” është punuar nga unë dhe nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara sipas rregullave të caktuara për një punim të mirëfilltë shkencor.

*Ky punim i dedikohet - Familjes sime*

*Shumë përqafime!*

*Njomza*

## ***Falënderime***

*Falënderimi i takon Zotit, që më ka dhuruar të gjitha këto mirësi dhe më ka mundësuar të arrij këtë sukses, poashtu një falënderim i pafund shkon për prindërit, të cilët kanë qënë mbështetja dhe përkrahja ime në çdo rrethanë dhe në çdo moment, ju jam mirënjohëse gjatë gjithë jetës dhe shpresoj që çdo herë do të ndihen krenar me mua.*

*Falënderim tejet të veçantë do të ndaj për shoqën time të ngushtë Arjeta Krasniqi, më të cilën kemi qënë gjithmonë së bashku gjatë tërë këtij rrugëtimi, ka qënë ajo e cila më ka përkrahur, më ka motivuar dhe mbi të gjitha çdo sfidë e kemi kaluar së bashku, andaj me plotëkuptim për mua është edhe thënia: “Të gjithë kanë një mik në çdo fazë të jetës, por vetëm njerëzit e lumtur kanë të njëjtin mik në të gjitha fazat e jetës”.*

*Një falënderim tjetër shkon për mentorën e temës, Prof. Asoc. Dr. Jehona Shkodra e cila ka qënë gjithnjë e gatshme për të më ndihmuar me sugjerime, këshilla duke më dhënë mbështetje të pakursyer për të finalizuar këtë punim.*

## Përmbajtja

Lista e tabelave .....	vii
Lista e figurave .....	vii
Abstrakti .....	1
Abstract .....	2
KAPITULLI I: HYRJE .....	3
1.1. Identifikimi i problemit dhe qëllimi i hulumtimit .....	4
1.2. Objektivat dhe hipotezat .....	5
KAPITULLI II: RISHIKIMI I LITERATURËS .....	6
KAPITULLI III: METODOLOGJIA DHE METODAT E PUNIMIT .....	10
KAPITULLI IV: ANALIZA E REZULTATEVE .....	11
4.1. Kosova .....	11
4.2. Shqipëria .....	17
4.3. Maqedonia.....	21
4.4. Mali i Zi .....	25
4.5. Serbia.....	29
4.6. Bosnja .....	33
4.7. Investimet e huaja në vendet EJL.....	37
KAPITULLI V: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME .....	38
Referencat.....	40

## Lista e tabelave

TABELA 1: Statistikat përshkruese për variablat e përfshira në model .....	13
TABELA 2: Analiza e korelacionit.....	14
TABELA 3: Analiza e regresionit.....	15
TABELA 4: Rëndësia e modelit ekonometrik.....	15
TABELA 5: Kontributi i variablave në BPV në përqindje.....	16
TABELA 6:Statistikat përshkruese për variablat e përfshira në model (Shqipëria) .....	18
TABELA 7: Analiza e korelacionit ( Shqipëria).....	19
TABELA 8: Analiza e regresionit (Shqipëria) .....	19
TABELA 9: Rëndësia e modelit ekonometrik (Shqipëria).....	20
TABELA 10: Kontributi i variablave në BPV në përqindje (Shqipëria) .....	20
TABELA 11: Statistikat përshkruese për variablat e përfshira në model (Maqedoni).....	22
TABELA 12: Analiza e korelacionit (Maqedoni).....	23
TABELA 13: Analiza e regresionit (Maqedoni).....	23
TABELA 14: Rëndësia e modelit ekonometrik (Maqedoni) .....	24
TABELA 15: Kontributi i variablave në BPV në përqindje .....	24
TABELA 16: Statistikat përshkruese për variablat e përfshira në model (Mali i Zi) .....	26
TABELA 17: Analiza e korelacionit (Mali i Zi).....	26
TABELA 18: Analiza e regresionit (Mali i Zi).....	27
TABELA 19: Rëndësia e modelit ekonometrik (Mali i Zi).....	27
TABELA 20: Kontributi i variablave në BPV në përqindje.....	28
TABELA 21: Statistikat përshkruese për variablat e përfshira në model (Serbi) .....	30
TABELA 22: Analiza e korelacionit (Serbi) .....	30
TABELA 23: Analiza e regresionit ( Serbi) .....	31
TABELA 24: Rëndësia e modelit ekonometrik (Serbi) .....	31
TABELA 25: Kontributi i variablave në BPV në përqindje (Serbi) .....	32
TABELA 26: Statistikat përshkruese për variablat e përfshira në model (Bosnjë) .....	34
TABELA 27: Analiza e korelacionit (Bosnjë).....	34
TABELA 28: Analiza e regresionit (Bosnjë) .....	35
TABELA 29: Rëndësia e modelit ekonometrik (Bosnjë).....	35
TABELA 30: Kontributi i variablave në BPV në përqindje (Bosnjë).....	36
TABELA 31: Krahasimi i investimeve të huaja direkte: Kosovë- shtetet e rajonit .....	37

## Lista e figurave

FIGURA 1: Investimet e huaja direkte në Kosovë gjatë periudhës 2005-2020 .....	11
FIGURA 2: Investimet e huaja direkte në Shqipëri gjatë periudhës 2005-2020 .....	18
FIGURA 3: Investimet e huaja direkte në Maqedoni gjatë periudhës 2005-2020 .....	22
FIGURA 4: Investimet e huaja direkte në Malin e Zi gjatë periudhës 2005-2020.....	25
FIGURA 5: Investimet e huaja direkte në Serbi gjatë periudhës 2005-2020 .....	29
FIGURA 6: Investimet e huaja direkte në Bosnjë gjatë periudhës 2005-2020.....	33

## Abstrakti

Duke marrë parasysh rëndësinë e zhvillimit ekonomik për një vend ne kemi analizuar cilët janë faktorët që ndikojnë në këtë zhvillim përkatësisht qëllimi i këtij punimi do të jetë të shihet ndikimi i investimeve të huaja direkte në këtë aspekt. Fillimisht do të prezentojmë disa nga veqoritë e investimeve të huaja direkte, ndarjen buxhetore për shpenzimet qeveritare dhe lidhshmërinë e këtyre faktorëve në ndërtimin e modelit ekonometrik.

Fokusi kryesor gjatë këtij hulumtimi do të jetë tek investimet e huaja direkte të cilat nëpërmjet kontributeve të tyre direkte dhe indirekte, mund të shërbejnë si shtytës kryesor në ristrukturimin e ndërmarrjeve si dhe në ristrukturimin e përgjithshëm ekonomik.

Nga rezultatet që kemi marr arrijmë në përfundim se në Kosovë këto investime nuk kanë një ndikim apo efekt pozitiv në rritjen ekonomike, poashtu edhe në disa nga vendet e rajonit e kemi po të njëjtin rezultat.

**Fjalë kyqe:** Rritja ekonomike (BPV), investimet e huaja direkte, shpenzimet qeveritare.



## Abstract

Considering the importance of economic development for a country we have analyzed what are the factors that affect this development, respectively the purpose of this paper will be to see the impact of foreign direct investment in this regard. We will first present some of the features of foreign direct investment, budget allocation for government spending and the relevance of these factors in building the econometric model.

The main focus during this research will be on foreign direct investments which through their direct and indirect contributions, can serve as the main driver in the restructuring of enterprises as well as in the overall economic restructuring.

From the results we have obtained we conclude that in Kosovo these investments don't have a positive impact or effect on economic growth, also in some of the countries in the region we have the same result.

**Keywords:** Economic growth (GDP), foreign direct investment, government spending.

## KAPITULLI I: HYRJE

Dy indikatorë të rëndësishëm për zhvillim ekonomik janë investimet dhe tregtia. Investimet e Huaja Direkte (IHD) janë kapitali i huaj që investohet në një vend. Këto të hyra ndihmojnë rritjen e BPV-së dhe performancën e përgjithshme ekonomike. Për realizimin e këtyre të hyrave supozohen reforma të ndryshme të tërheqjes së investimeve të huaja direkte përfshirë lehtësira procedurale në investimin e kapitalit të huaj, përmirësimin e efikasitetit të gjykatave për trajtimin e çështjeve ekonomike dhe thellimin e marrëdhënieve ndërkombëtare për tregti (GAP, 2021).

Ndërsa bruto produkti vendor (BPV) është treguesi më i rëndësishëm ekonomik i llogarive kombëtare, i cili paraqet performancën ekonomike të një shteti në një periudhë të caktuar. BPV gjithashtu është një matës agregat i vlerave të të gjitha produkteve dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuara në një ekonomi. Andaj, është e rëndësishme që BPV të matet për të gjykuar gjendjen e një ekonomie dhe dinamikën e saj (MZHE, 2018).

Sipas Zyrës së Statistikave të BE-së (EUROSTAT), IHD është kategori e investimeve ndërkombëtare që pasqyron objektivin e realizimit të interesit të qëndrueshëm nga investitori i një ekonomie në një ndërmarrje rezidente në një ekonomi tjetër.

Pra, Investimet e huaja direkte janë angazhimet e kapitalit nga një person fizik ose juridik me qëllim përfitimin e një interesi të qëndrueshëm ose marrjen e kontrollit të një kompanie ose ndërmarrje që vepron jashtë vendit. Sipas këtij përkufizimi, investimet e huaja mund të marrin tri forma kryesore: blerja e të paktën 10% të aksioneve të një shoqërie që operon në një vend të huaj; krijimi i një kompanie jashtë territorit kombëtar dhe riinvestimi i fitimeve të realizuara nga një kompani me bazë jashtë vendit (Cani, 2015).

Vendet ose kompanitë që duan të bëjnë investime direkte në një vend më pak të zhvilluar kanë motive të ndryshme që nxisin vendimet e tyre. Motivet për investime të huaja në thelb kanë nevojën për të përfituar në maksimum në gjetjen e resurseve njerëzore me kosto më të ulët, në gjetjen e aseteve strategjike, gjetjen e tregjeve për të zhvilluar biznesin e tyre në mënyrë më të leverdishme, gjë që nuk është e mundur brenda vendeve të origjinës (Besa Zogaj- Gashi, 2019).

## **1.1. Identifikimi i problemit dhe qëllimi i hulumtimit**

Investimet e huaja direkte (IHD) besohet të jenë një faktorë i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik mirëpo ndikimi i tyre ndryshon në vende të ndryshme. Prania e faktorëve të ndryshëm mund të rrisë ose ngadalësojë ndikimin e mundshëm të investimeve të huaja në rritjen ekonomike. Prandaj, ne e kemi parë të arsyeshme që të bëjmë një hulumtim në këtë drejtim në mënyrë që të identifikohet dhe matet ndikimi i investimeve të huaja direkte në zhvillimin ekonomik.

Duke hulumtuar raporte të ndryshme mbi të dhënat statistikore, ky punim ka marrë një qasje tërësore në studimin dhe analizimin e dinamikës së ndikimit të këtyre investimeve poashtu edhe të shpenzimeve qeveritare.

Andaj qëllimi i hulumtimit do të jetë në përcaktimin e shkallës së ndikimit të këtyre variablave në bruto produktin vendor, duke treguar se çfarë korelacioni apo lidhshmërie kemi mes investimeve të huaja direkte dhe shpenzimeve qeveritare në rritjen ekonomike të vendit.

Ky hulumtim do të përfshij një periudhë studimi nga viti 2005-2020.

## 1.2. Objektivat dhe hipotezat

- ◆ Objektivi i përgjithshëm:
  - ⇒ Ndikimi i investimeve të huaja direkte në rritjen ekonomike në Kosovë
  
- ◆ Objektivat specike:
  - ⇒ Roli dhe rëndësia e investimeve në aspektin e infrastrukturës ekonomike;
  - ⇒ Krijimi i kushteve për tërheqjen e investimeve;
  - ⇒ Lidhshmëria e shpenzimeve qeveritare me investimet e huaja direkte në ndikimin e zhvillimit ekonomik;
  
- ◆ Pytjet hulumtuese:
  - ⇒ Sa është shkalla e investimeve të huaja direkte në Kosovë?
  - ⇒ Sa është shkalla e investimeve të huaja direkte në shtetet e regjionit?
  - ⇒ Gjatë periudhës hulumtuese (2005-2020) sa ka qenë ndryshueshmëria e investimeve në % ?
  - ⇒ Cilat kushte duhet të i plotësoj një vend që të mund të tërheq investitor të jashtëm?
  - ⇒ Në çfarë rrethana investimet e huaja direkte mund të kenë ndikim negativ në aspekt ekonomik?
  - ⇒ Cila nga kategoritë e variablave të pavaruara ka ndikim më të lartë në bruto produktin vendor?
  
- ◆ Hipotezat:
  - 1) Investimet e huaja direkte kanë ndikim në zhvillimin ekonomik në Kosovë.
  - 2) Ekzistenca e pasigurisë për investime në një ekonomi të huaj.
  - 3) Raporti mes shpenzimeve qeveritare dhe investimeve të huaja është statistikisht i rëndësishëm për zhvillim të qëndrueshëm.

## KAPITULLI II: RISHIKIMI I LITERATURËS

Kjo temë është shqyrtuar në shumë raporte dhe publikime ndërkombëtare andaj për rolin dhe rëndësinë e saj në këtë pjesë do cekim disa nga këndvështrimet e autorëve.

Roli i investimeve të huaja direkte në nxitjen e rritjes dhe zhvillimit ekonomik ka qenë një kontestim që nga dekada e zhvillimit të OKB-së në vitet 1960. Gjithmonë ka pasur pikëpamje në favor të IHD-ve dhe kundër saj. Disa argumentojnë se IHD-të dërgojnë në rritjen ekonomike dhe rritjen e produktivitetit në ekonominë dhe kështu kontribuojnë në dallimet në rritjen ekonomike dhe zhvillimet në vendet e ndryshme, por të tjerët theksojnë rrezikun e IHD-ve që shkatërrojnë aftësitë lokale dhe nxjerrjen e burimeve natyrore pa kompensuar në mënyrë adekuate vendet e varfëra (Krasniqi, 2018).

Në mesin e grupit të madh të aspekteve politike, ligjore dhe sociale, zakonisht pranohet gjerësisht se investimet e huaja direkte (IHD) dhe eksportet përbëjnë dy faktorë të rëndësishëm që kontribuojnë në rritjen ekonomike të ekonomitë në zhvillim. Efektet pozitive të fluksit të IHD-ve ndodhin në shumë mënyra, IHD-të ndihmojnë në rritjen e investimeve duke çuar ndër të tjera, në krijimin e vendeve të reja të punës dhe në gjenerimin e të ardhurave tatimore (Nixha, 2017).

Përveç kësaj, IHD-të ofrojnë qasje në teknologji të përparuar që luan rol pozitiv në elementin e rritjes së gjithmbarshme të produktivitetit dhe në elementin e të ardhurave. Me investime nga firmat e huaja në ekonominë e pranuesit, teknologjia moderne dhe ekspertiza (njohuritë) përhapen me anë të lidhjeve dhe shkëmbimeve të ndryshme formale dhe joformale, duke ndihmuar kështu për të përmirësuar produktivitetin e tyre. Për më tepër, konkurrenca ndërkombëtare që rezulton nga fluksi i IHD-ve lejon që ekonomia pritëse t'i rrisë eksportet dhe të përmirësojë bilancin e pagesave dhe në shumë raste të bëjë lehtësimin e shtrëngimeve financiare ndërkombëtare ndaj rritjes ekonomike (Nixha, 2017).

IHD-të kontribuojnë në punësim në ekonominë vendore duke shtuar drejtpërdrejtë vende të reja pune dhe në mënyrë indirekte kur shpenzimet vendore rriten për shkak të blerjeve të mallrave dhe shërbimeve nga rritja e re e punonjësve. Të gjitha këto pritjet të kenë efekte shumëzuese pozitive për një ekonomi (Abdulhamid Sukar, 2006).

Për shembull, në një analizë empirike që është zhvilluar duke përdorur të dhëna ndër-vendore nga 47 vende për periudhën 1981-1999, është vërtetuar roli i sektorëve të ndryshëm në marrëdhëniet midis IHD-ve dhe rritjes ekonomike. Ata zbulojnë se efektet e IHD-ve në rritje varen nga sektori përmes të cilit IHD -të hyjnë në vendin pritës. Ata arrijnë në përfundimin se IHD-të kontribuojnë në rritje vetëm kur hyjnë në vendin pritës përmes sektorit të prodhimit, duke shtuar se flukset e tyre përmes sektorit primar kanë një efekt negativ në rritje ndërsa rezultatet janë të paqarta për sektorët e shërbimeve (Kamara, 2013).

Në të kundërt, disa studiues argumentojnë se nuk ka një lidhje të rëndësishme pozitive midis IHD-ve dhe rritjes ekonomike, kur marrëdhëniet janë pozitive, efektet priren të jenë të dobëta. Disa studime të tjera gjejnë një lidhje negative midis IHD-ve dhe rritjes ekonomike (Abdulhamid Sukar, 2006).

Një autor tjetër theksoi që flukset e IHD-ve nuk ndikojnë në rritjen ekonomike gjatë gjithë kohës. Kështu, vlerësimet e bazuara në një panel prej 57 vendeve në zhvillim për periudhën 1980 deri 1999 treguan se vendet me rritje të lartë ekonomike vunë re ndikimin e drejtpërdrejtë të investimeve, por kjo nuk është gjetur në vendet me rritje të ulët ekonomike, për shkak të heterogjenitetit të vendeve. Rezultatet u morën me përfshirjen e variablave instrumentale dhe disa variabla kontrolli që ndikojnë në rritjen ekonomike si konsumi i qeverisë, numri i linjave telefonike për mijëra njerëz, inflacioni, investimet vendore (Evans Kulu, 2021).

Duke analizuar shkallën në të cilën ndikohet rritja ekonomike nga hyrjet e IHD-ve në Nigeri, të dhëna vjetore të përdorura që përfshijnë vitet 1981-2007 dhe teknikën e vlerësimit, gjetjet tregojnë se këto investime stimulojnë rritjen, pra, një marrëdhënie pozitive. Gjithashtu, Emmanuel gjeti një lidhje pozitive midis IHD-ve dhe rritjes ekonomike, duke përdorur të dhënat e serive kohore nga 1981-2015, dhe teknikat e vlerësimit të regresionit të shumëfishtë, rezultati tregon një lidhje statistikisht të rëndësishme (Ebunolwa Oyegoke, 2021).

Në përputhje me gjetjet e një studimi në vitin 2003 theksohet se investimet kanë një efekt negativ në rritjen ekonomike të vendeve në zhvillim dhe faktorët vendas si kapitali njerëzor, hapja, zhvillimi i tregut financiar nuk mund të shpjegojnë efektet e rritjes së investimeve, megjithatë efekti i rritjes ekonomike lidhet pozitivisht me më pak ndërhyrje të qeverisë dhe rregullimin e biznesit dhe negativisht me varësinë nga burimet natyrore dhe paqëndrueshmërinë e IHD (Gokmen, 2021).

Një studim i realizuar në Kinë në të cilin janë përdorur të dhënat vjetore të serive kohore të Bankës Botërore nga viti 1985 deri në 2009 duke përdorur modelin e korigjimit të gabimit ka përcaktuar si variabla të hyrat neto të IHD-ve, formimin e kapitalit fiks bruto, shpenzimet e konsumit përfundimtar të qeverisë së përgjithshme për të shpjeguar variancat e mostrës në produktin e brendshëm bruto (Ebunolwa Oyegoke, 2021).

Gjetjet e studimit treguan një marrëdhënie pozitive afatshkurtër dhe afatgjatë midis IHD-ve dhe rritjes ekonomike në Kinë (Gokmen, 2021). Në Kamboxhi, IHD gjithashtu ndikojnë në rritjen ekonomike, të dhënat vjetore të serive kohore nga viti 2006-2016 të analizuar duke përdorur matricën e korrelacionit dhe regresionin e shumëfishtë për të hetuar ndikimin e IHD në rritjen ekonomike, kanë treguar për një lidhje pozitive (Ebunolwa Oyegoke, 2021).

Hulumtimet tregojnë se një rritje e investimeve çon në norma më të larta rritjeje në vendet e zhvilluara financiarisht në krahasim me normat e vëzhguara në vendet e varfëra financiarisht. Kushtet lokale, të tilla si zhvillimi i tregjeve financiare dhe niveli arsimor i një vendi, ndikojnë në ndikimin e IHD-ve në rritjen ekonomike (Avazov Nuriddin Rustamugli, 2021).

Destinacioni sektorial i IHD luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë, Investimet në sektorin prodhues kishin efekt pozitiv të rritjes ndërsa investimet në sektorët e shërbimeve (si financat, shitja me pakicë dhe telekomi) rezultuan në ndikim negativ. Nga ana tjetër u zbulua se përbërja sektoriale e këtyre investimeve ka qenë e rëndësishme edhe në Pakistan (Saswata Chaudhury, 2020).

Ata zbuluan se investimet në sektorin parësor dhe të shërbimeve rezultuan në rritje ekonomike, por ato kishin një rol shumë të kufizuar në sektorin e prodhimit ndërsa në rastin e Nepalit zbuluan se IHD në të gjithë sektorët kishin efekt pozitiv dhe domethënës në rritjen ekonomike. Bazuar në analizat e ndara sektoriale, studimi sugjeroi që qeveria duhet t'i japë përparësi IHD të orientuara drejtë eksportit sesa atyre të orientuara drejtë kërkesës së brendshme për të nxitur rritjen ekonomike (Saswata Chaudhury, 2020).

Në rastin e vendeve në zhvillim, IHD duket se kanë efekt më të vogël në rritje ekonomike, i cili i është atribuar ekzistencës së një efekt pragu. Me fjalë të tjera, këto vende duhet të kenë një nivel të caktuar zhvillimi në arsim, teknologji, infrastrukturë dhe shëndetësi në mënyrë që të përfitojnë nga një prani e huaj në treg (Soukayna Lakhbiz, 2018).



## KAPITULLI III: METODOLOGJIA DHE METODAT E PUNIMIT

Gjatë këtij punimi ne kemi përdorur të dhëna dytësore për të mbledhur statistikat për investimet e huaja direkte dhe për shpenzimet qeveritare, do të thotë këto të dhëna janë mbledhur nga raportet e ndryshme për Kosovën dhe vendet e regjionit (Shqipërinë, Malin e Zi, Serbinë, Maqedonin dhe Bosnjën) nga burimet e faqeve zyrtare shtetërore, ndërsa literatura është huazuar nga publikimet e ndryshme shkencore të viteve të fundit.

Të gjitha këto të dhëna statistikore i kemi vendosur në një databazë që pastaj ti transferojmë në programin softverik që do ta përdorim për studim - *Minitabin*, në bazë të një ekuacioni ekonometrik:

$$Y = \beta_0 + \beta_1 X_1 + \beta_2 X_2 + \beta_3 X_3 + \beta_4 X_4 + \beta_5 X_5 + \beta_6 X_6 + e_i ;$$

- Y: Rritja ekonomike (BPV)
- X<sub>1</sub>: Investimet e huaja direkte
- X<sub>2</sub>: Pagat dhe mëditje
- X<sub>3</sub>: Mallrat dhe shërbimet
- X<sub>4</sub>: Subvencionet
- X<sub>5</sub>: Transfere sociale
- X<sub>6</sub>: Shpenzimet kapitale.

ku si variabël të varur do të vendosim bruto prodhimin vendor ndërsa si variabla të pavarura do të jenë shpenzimet qeveritare (mallra dhe shërbime, paga dhe mëditje, transfere sociale, subvencione, shpenzimet kapitale) dhe investimet e huaja direkte. Këto të dhëna përfshijnë periudhën nga viti 2005 deri në vitin 2020, dmth një periudhë gjashtëmbëdhjet (16) vjeqare.

Metodat e përdorura në punim janë: Metoda deskriptive-përshkruese, metoda e analizës (sasiore dhe cilësore), metoda krahasuese si dhe metoda statistikore.

Në bazë të ekuacionit të përdorur gjatë tërë hulumtimit do të mund të kuptojmë së cilët nga faktorët e përfshirë në model do të ketë ndikim në rritjen ekonomike dhe çfarë lidhje do të kenë ato mes vete.

## KAPITULLI IV: ANALIZA E REZULTATEVE

### 4.1. Kosova

Investimet e huaja direkte kontribuojnë në zhvillimin e sektorit prodhues të vendit. Aktualisht mundësia e vetme për zhvillim ekonomik në Kosovë janë investimet nga jashtë për faktin se kapacitetet për investime vendore janë shumë të limituara. Investimet e jashtme direkte kanë filluar që pas vitit 2000 ndërkaq investimet më voluminoze janë bërë në vitet 2007 – 2008. Investimet e mëdha të viteve 2007 – 2008 i dedikohen investimit në telefonin e dytë mobile në Kosovë. Rënia e investimeve të huaja direkte u vërejt nga fundi i vitit 2008 dhe fillimi i vitit 2009 nga kriza ekonomike globale ku investimet e jashtme patën rënie drastike. Ndërkaq më 2010 – 2011 filloi rritja e investimeve edhe pse me një ritëm shumë të ngadalshëm (Sokol Domniku, 2014).

Këto investime ende vazhdojnë të jenë të ndikuara nga zhvillimet ekonomike në botë konkretisht të eurozonës. Kriza ekonomike në eurozonë ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në numrin e investimeve në Kosovë, arsyeja është e thjeshtë ngase si në rastin e krizës globale ashtu edhe në këtë të eurozonës, kur investitorët e mundshëm të jashtëm në vendet e tyre kanë kriza, atëherë automatikisht bie edhe mundësia dhe dëshira që ata të investojnë në vende të tjera, në këtë rast në Kosovë (Sokol Domniku, 2014).




FIGURA 1: Investimet e huaja direkte në Kosovë gjatë periudhës 2005-2020

Përkundër trendit pozitiv të investimeve të huaja direkte në vitin 2019 (një rritje e vogël) në krahasim me vitin 2018, sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës., IHD-të pësuan rënie të konsiderueshme gjatë vitit 2018 dhe 2017, duke lënë Kosovën si një vend jo tërheqës për investime të huaja dhe larg tërheqjes së investimeve nga korporatat dhe markat e mëdha botërore. Rritja e IHD-ve u evidentua kryesisht në sektorin e pasurive të paluajtshme, sektorin e minierave, energji elektrike dhe tregti, ndërsa shërbimet financiare dhe sektori i ndërtimeve shënuan rënie. Nëse krahasojmë investimet e huaja sipas shteteve, Gjermania, Zvicra, Britania e Madhe, Turqia, Austria dhe Shqipëria, këto shtete ndër vite kanë dhënë një kontribut të madh sa i përket IHD-ve në Kosovë (Besa Zogaj- Gashi V. B., 2020).

Sipas të dhënave nga Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK,) që operon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në Kosovë ka shumë biznese në pronësi të huaj. Shumica dërrmuese e tyre, rreth 80 % janë të regjistruar vetëm në katër sektorë: tregti (36,72 %), shërbime (15,35%), prodhim (13,76 %) dhe ndërtim (12,35 %). Do të thotë se këta sektorë ekonomik janë më tërheqës për investitorët e huaj pasi kanë drejtuar investimet atje. Një pjesë kaq e madhe në tregti nuk është se ka ndikim në punësim dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, pasi paratë që ekzistojnë në tregun e Kosovës transferohen në vendet tjera nga vijën tregtia. Domosdoshmërisht duhen gjetur forma dhe politika investimi për të nxitur këto biznese të kalojnë në prodhim (Arben Sahiti, 2020).

Një pjesë e madhe e investimeve në patundshmëri në Kosovë bëhen nga diaspora. Siç tregon edhe anketa e kryer nga UNDP, mbi 35% e diasporës janë përgjigjur se investojnë në Kosovë, kryesisht në blerjen e patundshmërive për përdorim personal (60%) dhe investim në biznese familjare (23%). Gjatë dhjetë viteve të fundit, investimet e huaja direkte në Kosovë kanë pësuar luhatje dhe nuk kanë qenë të qëndrueshme (GAP, 2020).

Për dallim nga vitet e kaluara, në periudhën e pandemisë (2020), të hyrat nga IHD-të kanë rënë. Sektori më i goditur është pikërisht ai i patundshmërive i cili në dy vitet e kaluara në periudhën mars-qershor kishte bilanc pozitiv prej mbi 70 milionë eurove, ndërsa në 2020 ka rënë në 42 milionë euro apo një rënie prej 40% (GAP, 2020).

Për të tërhequr investimet e huaja, Kosova ka krijuar një kornizë ligjore që u garanton investitorëve të huaj të drejtën e përfshirjes dhe trajtimit kombëtar në pothuajse çdo sektor të ekonomisë, duke siguruar stimuj tërheqës për kompanitë e huaja në vend. Kosova ka një pozitë të shkëlqyeshme gjeostrategjike, një ekonomi me kosto konkurruese dhe norma të ulëta tatimore, një fuqi punëtore të re me aftësi të reja të cilat janë vazhdimisht në rritje dhe një angazhim për integrimin global të tregtisë (Sytrime Dervisholli, 2020).

Për të parë se sa kanë ndikuar ndër vite këto investime në zhvillimin ekonomik, ne kemi përpunuar të dhënat përmes programit të minitabit dhe kemi arritur rezultatet e mëposhtme:

*TABELA 1: Statistikat përshkruese për variablat e përfshira në model*

<b>Descriptive Statistics:</b>					
Variable	N	Mean	StDev	Minimum	Maximum
BPV	16	5104	1326	3068	7056
Paga dhe mëditje	16	404.1	179.8	43.0	661.0
Mallra dhe shërbime	16	198.3	43.9	131.0	280.0
Subvencionet	16	364.4	194.8	153.0	868.0
Transfere sociale	16	284.7	165.0	38.4	673.0
Shpenzimet kapitale	16	423.3	173.7	101.0	726.0
IHD	16	287.4	85.6	107.6	440.7

*Burimi: Kalkulim nga autorja*

Gjatë përpunimit të të dhënave ne kemi përfshirë disa analiza në model duke filluar nga analiza e korelacionit, regresionit, variancës dhe koeficientin e determinimit për rëndësinë e modelit ekonometrik.

Duke filluar nga analiza e korelacionit, e cila përdoret për të matur fortësinë e raporteve (korelacionit) në mes të dy variablave. Ajo matet përmes koeficientit të korelacionit ( $r$ ) që merr vlerat prej -1 deri në 1. Sa më afër vlerës 1 kemi lidhje të fortë ose funksionale në mes variablave, ndërsa sa më afër 0, korelacioni apo lidhja mes variablave është e dobët.

Në bazë të rezultateve, shohim se kemi një lidhje të fortë mes shpenzimeve qeveritare dhe bruto produktit vendor përveç investimeve të huaja direkte të cilat kanë një raport të

zhdrejtë apo lidhje të dobët negative me bruto produktin vendor poashtu edhe në raport me kategoritë e tjera të shpenzimeve qeveritare, investimet e huaja kanë lidhje të dobët.

**TABELA 2: Analiza e korelacionit**

<b>Correlation:</b>						
	BPV	Paga/m.	Mallra/sh.	Subvencionet	T.sociale	Sh.kapitale
Paga dhe mëditje	0.980					
Mallra dhe shërbime	0.959	0.942				
Subvencionet	0.874	0.857	0.926			
Transfere sociale	0.887	0.887	0.907	0.937		
Shpenzimet kapitale	0.732	0.707	0.644	0.405	0.511	
IHD	-0.117	-0.021	-0.042	-0.096	0.040	0.007
Cell Contents: Pearson correlation						

*Burimi: Kalkulim nga autorja*

Sa i përket analizës së regresionit, ajo shfrytëzohet për të vlerësuar variablën e varur (Y) bazuar në ndryshimin e variablit/ave të pavarur (X). Shenja pozitive e një koeficienti tregon marrëdhënie pozitive midis variablit të varur dhe variablit përkatës, që do të thotë nëse rritet X atëherë pritet një rritje e Y, e kundërta do të ishte nëse një variabël ka një shenjë negative.

Në tabelën e mëposhtme ne kemi fituar vlerat e koeficientëve të regresionit dhe në bazë të tyre ne konstatojmë se investimet e huaja direkte kanë një lidhje negative me BPV pasi që me rritjen e investimeve të huaja për një njësi do të kemi ulje të bruto prodhimit për 1.409, kurse për variablat e tjera raporti është pozitiv. Vlera e p-së për investimet e huaja dhe për shpenzimet e pagave dhe mëditjeve është më e vogël se 0.05 që tregon se këto dy variabla janë statistikisht të rëndësishme për modelin.

**TABELA 3: Analiza e regresionit**

<b>Coefficients</b>						
<b>Term</b>	<b>Coef</b>	<b>SE Coef</b>	<b>95% CI</b>	<b>T-Value</b>	<b>P-Value</b>	<b>VIF</b>
Constant	1801	603	( 438, 3164)	2.99	0.015	
Paga dhe mëditje	4.24	1.03	( 1.90, 6.58)	4.10	0.003	12.00
Mallra dhe shërbime	6.27	5.88	( -7.02, 19.57)	1.07	0.314	23.09
Subvencionet	0.61	1.37	( -2.49, 3.70)	0.44	0.668	24.67
Transfere sociale	0.31	1.17	( -2.33, 2.96)	0.27	0.795	12.93
Shpenzimet kapitale	1.042	0.612	(-0.344, 2.427)	1.70	0.123	3.93
IHD	-1.409	0.695	(-2.980, 0.162)	-2.03	0.073	1.23

*Burimi: Kalkulim nga autorja*

Vlera e koeficientit të determinimit tregon për rëndësinë e modelit ekonometrik që në këtë rast është 98.53%, kjo vlerë tregon se 98.53 % e ndryshimit të rritjes ekonomike vjen nga ndryshimi i shpenzimeve qeveritare dhe investimeve të huaja direkte.

**TABELA 4: Rëndësia e modelit ekonometrik**

<b>Model Summary</b>				
<b>S</b>	<b>R-sq</b>	<b>R-sq(adj)</b>	<b>PRESS</b>	<b>R-sq(pred)</b>
207.762	98.53%	97.54%	2918809	88.93%

*Burimi: Kalkulim nga autorja*

Nga kontributi në përqindje, pagat dhe mëditjet kontribuojnë më së shumti me 95.97% ndërsa kontributin më të vogël kanë subvencionet dhe transferet sociale me 0.01%, kurse investimet e huaja direkte kontribuojnë me 0.67%, 1.47% janë faktorë të tjerë të pashpjegueshëm në model.

**TABELA 5: Kontributi i variablave në BPV në përqindje**

<b>Analysis of Variance</b>							
<b>Source</b>	<b>DF</b>	<b>Seq SS</b>	<b>Contribution</b>	<b>Adj SS</b>	<b>Adj MS</b>	<b>F-Value</b>	<b>P-Value</b>
Regression	6	25972335	98.53%	25972335	4328723	100.28	0.000
Paga dhe mëditje	1	25299489	95.97%	726337	726337	16.83	0.003
Mallra dhe shërbime	1	301817	1.14%	49187	49187	1.14	0.314
Subvencionet	1	1528	0.01%	8483	8483	0.20	0.668
Transfere sociale	1	2283	0.01%	3094	3094	0.07	0.795
Shpenzimet kapitale	1	189639	0.72%	124888	124888	2.89	0.123
IHD	1	177579	0.67%	177579	177579	4.11	0.073
Error	9	388486	1.47%	388486	43165		
Total	15	26360821	100.00%				

*Burimi: Kalkulim nga autorja*

## 4.2. Shqipëria

Shqipëria zbaton një sistem liberal të investimeve të huaja, me qëllim rritjen e tyre në vend. Ligji "Për Investimet e Huaja" lejon një pronësi 100% për kompanitë e huaja dhe përshkruan mbrojtje specifike për investitorët e huaj. Shqipëria është e angazhuar për zhvillimin e një klime të qëndrueshme dhe të parashikueshme të biznesit duke vazhduar zbatimin e reformave thelbësore, konsolidimin fiskal që synon uljen e borxhit kombëtar, përmirësimin e bashkëpunimit rajonal, investimet në infrastrukturë dhe reformën e sistemit arsimor (AIDA, 2020).

Qeveria shqiptare, gjithashtu ka ecur përpara me një agjendë ambicioze të reformave ekonomike dhe strukturore, e cila do të kontribuoj në një mjedis më tërheqës të biznesit: rivendosjen e rritjes, përmirësimin e konkurrencës dhe krijimin e vendeve të reja të punës (AIDA, 2020).

Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë vitit 2019 kanë qenë 6.443 ndërmarrje të cilat janë të përqendruara kryesisht në aktivitetet ekonomike si call center, prodhimi i këpucëve dhe aktiviteti bankar (INSTAT, 2020).

Për treguesin e punësimit, përqindja më e lartë e ndërmarrjeve me pronësi të huaj dhe të përbashkët për periudhën kohore 2017-2019 është në sektorin e industrisë përpunuese mesatarisht 38% kurse për treguesin e investimeve, përqindja më e lartë e ndërmarrjeve me pronësi të huaj dhe të përbashkët për periudhën kohore 2017-2019 është në sektorin e energjisë elektrike dhe hidrocentrale mesatarisht 29,9% (INSTAT, 2020).

Ndërsa nivelin e investimeve të huaja direkte në Shqipëri gjatë periudhës 2005-2020 e kemi paraqitur në figurën e mëposhtme:






FIGURA 2: Investimet e huaja direkte në Shqipëri gjatë periudhës 2005-2020

### Analiza konkrete hulumtuese

TABELA 6: Statistikat përshkruese për variablat e përfshira në model (Shqipëria)

Descriptive Statistics:					
Variable	N	Mean	StDev	Minimum	Maximum
BPV	16	1304433	266816	814797	1679247
Paga dhe mëditje	16	63933	6473	53674	76962
Mallra dhe shërbime	16	35596	8518	22794	48906
Subvencionet	16	2377	886	1421	3835
Transfere sociale	16	121326	41262	55876	179364
Shpenzime kapitale	16	68233	15006	38375	95881
IHD	16	750.5	255.8	213.0	1079.0

Burimi: Kalkulim nga autorja

Tek analiza e korelacionit, kemi një lidhshmëri shumë të fortë pozitive mes investimeve të huaja direkte dhe bruto produktit vendor pasi që koeficienti i korelacionit arrinë vlerë afër 1 dmth (0.935) dhe i njëjti raport i IHD-ve qendror edhe me kategoritë e tjera të shpenzimeve qeveritare që na tregon për një lidhshmëri shumë të fortë pozitive mes këtyre variablave.

**TABELA 7: Analiza e korelacionit ( Shqipëria)**

<b>Correlation:</b>						
	BPV	Paga/m.	Mallra/shërb.	Subvencionet	T.sociale	Sh.kapitale
Paga dhe mëditje	0.606					
Mallra dhe shërbime	0.937	0.557				
Subvencionet	-0.805	-0.463	-0.712			
Transfere sociale	0.990	0.570	0.954	-0.796		
Shpenzime kapitale	0.397	0.585	0.384	-0.435	0.332	
IHD	0.935	0.533	0.863	-0.832	0.908	0.502
Cell Contents: Pearson correlation						

*Burimi: Kalkulim nga autorja*

Nëse shohim raportin e analizës së regresionit do të vërejmë që investimet e huaja direkte kanë një ndikim shumë të madh në zhvillimin ekonomik për dallim nga Kosova që kishim një raport negativ të kësaj kategorie, në këtë rast mund të themi që me rritjen e investimeve të huaja direkte për një njësi do të kemi rritje të BPV për 203.4 mil. euro po ashtu edhe nga analiza e rëndësisë së faktorëve në model shohim se investimet e huaja direkte kanë një vlerë të p-së (0.069) që tregon se është një faktorë statistikisht i rëndësishëm për modelin. Të njëjtin raport e kemi fituar edhe për variablat e tjera të përfshira në model përveç mallra dhe shërbimeve që kanë një raport të zhdrejtë apo negativ, që me rritjen e shpenzimeve për këtë kategori do të kemi ulje të BPV për 3.96.

**TABELA 8: Analiza e regresionit (Shqipëria)**

<b>Coefficients</b>						
Term	Coef	SE Coef	95% CI	T-Value	P-Value	VIF
Constant	381834	118035	(114821, 648847)	3.23	0.010	
Paga dhe mëditje	1.72	1.93	( -2.64, 6.08)	0.89	0.395	2.27
Mallra dhe shërbime	-3.96	3.62	( -12.15, 4.23)	-1.09	0.302	13.88
Subvencionet	12.9	18.3	( -28.5, 54.3)	0.70	0.500	3.84
Transfere sociale	6.04	1.04	( 3.68, 8.39)	5.79	0.000	27.02
Shpenzime kapitale	0.558	0.893	(-1.462, 2.577)	0.62	0.548	2.62
IHD	203.4	98.7	( -19.9, 426.7)	2.06	0.069	9.31

*Burimi: Kalkulim nga autorja*

Ky model ekonometrik është vlerësuar si një model mjaftë i rëndësishëm pasi që vlera e koeficientit të determinimit është 99.13% e cila tregon se 99.13% e ndryshimit të bruto produktit vendor vjen nga ndryshimi i shpenzimeve qeveritare dhe investimeve të huaja direkte.

**TABELA 9: Rëndësia e modelit ekonometrik (Shqipëria)**

<b>Model Summary</b>				
<b>S</b>	<b>R-sq</b>	<b>R-sq(adj)</b>	<b>PRESS</b>	<b>R-sq(pred)</b>
32058.8	99.13%	98.56%	3.58859E+10	96.64%

*Burimi: Kalkulim nga autorja*

Nga kontributi në përqindje, mund të vërejmë se investimet e huaja direkte kontribuojnë me 0.41% në rritjen ekonomike në nivel vendi në Shqipëri, ndërsa kontributin më të lartë e kanë shpenzimet për mallra dhe shërbime 52.06%, kurse 0.87% janë faktorë të tjerë të pashpjegueshëm në model.

**TABELA 10: Kontributi i variablave në BPV në përqindje (Shqipëria)**

<b>Analysis of Variance</b>					
<b>Source</b>	<b>DF</b>	<b>Seq SS</b>	<b>Contribution</b>	<b>Adj SS</b>	<b>Adj MS</b>
Regression	6	1.05861E+12	99.13%	1.05861E+12	1.76435E+11
Paga dhe mëditje	1	3.92602E+11	36.77%	821269842	821269842
Mallra dhe shërbime	1	5.55942E+11	52.06%	1230878517	1230878517
